



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 02.08.2024

Nr: 14

Ora: 20:00

VENDIM

PËR

PRANIMIN PËR SHOYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 8, DATË 02.08.2024 TË DEPOZITUAR NGA “Z. ARQILEA BOLLANO, KRYETAR I KOMANDUAR, BASHKIA HIMARË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.08.2024, me pjesëmarrjen e:

| | | | |
|-----------------|----------------|---|----------------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Illirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

| | |
|----------------------|---|
| ANKUES: | Arqilea Bollano, kryetar i komanduar, bashkia Himarë |
| OBJEKT: | Kundërshtim i vendimit nr. 159, datë 01.08.2024 “Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar të bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. |
| BAZË LIGJORE: | Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. |

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 02.08.2024

Nr: 14

Ora: 20:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 8, datë 02.08.2024 të depozituar nga z. Arqilea Bollano, kryetar i komanduar, bashkia Himarë

VËREN:

Z. Arqilea Bollano, kryetar i komanduar në bashkisë Himarë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 8 regj., datë 02.08.2024.

Në mbledhjen e datës 02.08.2024, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 8, datë 02.08.2024 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe subjekti ankimues ka interes në kuptim të nenit 124/1, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 8, datë 02.08.2024, të kryetarit në detyrë të bashkisë Himarë.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet në seancën e datës 02.08.2024, ora 21:15.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

| | | | |
|------------------|----------------|---|----------------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Ilijarjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |